



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E DREJTËSISË  
 MINISTRI

Nr. 1094/4 Prot.  
 (lutemi t`i referoheni në rast përgjigjeje)

Tiranë, më 28 / 2 /2017

**Lënda:** Mbi sqarimin e zj. Calavera për Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit.

**Drejtuar:** SH.T.ZNJ. ROMANA VLAHUTIN  
 AMBASADORE E DELEGACIONIT TË BASHKIMIT EUROPIAN NË  
 REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

**Për Dijeni :**

SH.T.Z. BUJAR NISHANI  
 PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

SH.T.Z. ILIR META  
 KRYETAR I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

SH.T.Z. EDI RAMA  
 KRYEMINISTËR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

SH.T.Z. DONALD LU  
 AMBASADOR I SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS NË REPUBLIKËN  
 E SHQIPËRISË

**E nderuar Znj. Vlahutin,**

Para së gjithash më lejoni t`Ju falënderoj për komunikimin Tuaj të fundit, nëpërmjet të cilit përcillet një sqarim i zj. Genoveva Ruiz-Calavera, lidhur me rolin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM).

Nga shqyrtimi i kujdesshëm i këtij komunikimi, do të vlerësoja për t`u marrë në konsideratë disa momente:

*Së pari*, krijimi i një PMU-je (*Project Management Unit*) për projektin IPA për Rivlerësimin Kalimtar të Prokurorëve dhe Gjyqtarëve (*Vetting-ut*), krijon një kornizë të karakterit organizativ dhe mund të vlerësohet si një hap i parë dhe i dobishëm, për zbatimin e procesit *vetting*.

*Së dyti*, në sqarimin e zj. Calavera, shfaqet termi i ri i strukturës "Governing Board", ndërkohë që në prezantimin e mëparshëm të datës 07 shkurt 2017, kjo strukturë emërtohej "Management Board" dhe nuk ka asnjë shpjegim për këtë ndryshim të emërtimit, pasi në vlerësimin tonë ndryshimi i emërtesës llogjikisht lidhet edhe me mënyrën e funksionimit të tij, apo rolit që ai do të ketë konkretisht në proces.

*Së treti*, në përmbledhje të këtij sqarimi zj. Calavera, referon se "këtej e në vijim për të mos patur asnjë keqkuptim, çdo komunikim do t'i referohem vetëm ONM-së (IMO)".

Kjo situatë kërkon sqarim të mëtejshëm, pasi duhet qartësuar në mënyrë shteruese nëse komunikimi do të mbahet nëpërmjet PMU-së, e cila paraqet në vetëvehte realisht një strukturë gjithëpërfshirëse apo ONM-së, e cila ka një parashikim kushtetues të mirëpërcaktuar.

*Se katërti*, duke vlerësuar të gjitha komunikimet në vijimësi dhe përkatësisht letrën e zj. Calavera në datën 07 shkurt, letrën e z. Hahn të datës 17 shkurt, si dhe komunikimin më të fundit të zj. Calavera, të datës 27 shkurt 2017, në funksion të detyrimeve ligjore, që procesi i *vetting* ka, është shumë e domosdoshme të përpilohet Rregullorja e Funksionimit të PMU-së.

Kjo Rregullore e funksionimit të PMU do të përshkruajë qartë;

- a. mënyrën e komunikimit të PMU-së me institucionet shqiptare,
- b. mënyrën e akreditimit të vëzhguesve ndërkombëtarë si pjesë e ONM-së, për tu mundësuar vëzhguesve ndërkombëtare komunikimin e drejtpërdrejtë dhe pa asnjë kufizim me institucionet që parashikon Kushtetuta dhe ligji, me objekt të përcaktuar,

- c. rregullat e pajisjes se tyre me gjithë Certifikatat përkatëse të Sigurisë, që u mundësojnë shqyrtimin e dokumentave të caktuara shtetërore, si dhe,
- d. mënyrën komunikimit të rekomandimeve të tyre, në adresë të institucioneve shqiptare të ngarkuara me ligj për rivlerësimin kalimtar.

**Së fundmi**, ashtu sikurse është parashikuar edhe nga termat e projektit IPA që financon procesin e Vetting-ut, duhet përcaktuar sa më parë edhe **Përfaqësuesi i Shqipërisë**, në Komitetin Drejtues të Projektit.

Qartësimi i momenteve të mësipërme është tepër i rëndësishëm pasi siguron transparencë në komunikim, qartëson rolin, detyrat dhe përgjegjësitë e gjithësecilit në proces, si dhe eviton keqkuptime apo keqinterpretimet, të cilat do të sillnin vonesa të pajustificueshme dhe vështirësi në zbatimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Gjithashtu reflektimet e mësipërme, do të ishin hapa të mëtejshëm në respektimin e ligjshmërisë, që rregullon procesin e vetting-ut, duke e bërë atë sa më solid dhe të pa atakueshëm, si dhe adresojnë një pjesë të shqetësimeve të ngritura më parë në komunikimet tona me Ju.

Me Respekt,

MINISTRI  
PUBLIK I SHQIPËRIE-SIS  
PËR  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
PETRIT VASILL

